RAPORTI VJETOR 2025

ALBSIG INVEST

Albsig Invest sh.a.
Fondi i Investimit Albsig Standard
Fondi i Pensionit Privat Albsig
Fondi i Pensionit Privat Smart Pension

PASQYRA PËRMBLEDHËSE

MESAZH NGA ADMINISTRATORI I PËRGJITHSHËM 4

1. SHOQËRIA ALBSIG INVEST SH.A.
1.1. Struktura e aksionerëve të shoqërisë administruese 5
1.2. Objektivat e shoqërisë administruese 5
1.3. Misioni dhe vlerat bazë 5
1.4. Këshilli i administrimit 6
1.5. Misioni dhe vlerat bazë 7
1.6. Këshilli i administrimit 7

2. PËRGJEGJËSIA SOCIALE
2.1. Simultane Shahu dhe Ping Pong në Maarif 8
2.2. Një ditë në ALBSIG dhe ALBSIG INVEST, Aleksandra dhe Melisa pjesë e projektit "Drejtues për një ditë" nga Junior Achievement of Albania 8
2.3. ALBSIG dhe ALBSIG INVEST në Panairin e Karrierës të Western Balkans University 9
2.4. ALBSIG dhe ALBSIG INVEST organizon një ditë dhurimi gjaku në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar 9
2.5. ALBSIG dhe ALBSIG INVEST në Samitin Ekonomik Shqipëri—Turqi: Një hap i ri drejt forcimit të partneritetit strategjik dhe zhvillimit të qëndrueshëm 10
2.6. ALBSIG dhe ALBSIG INVEST për Tetorin Rozë. Kujdes, ndërgjegjësim dhe mbështetje — sepse shëndeti fillon me kujdesin ndaj vetes 11
2.7. ALBSIG dhe ALBSIG INVEST forcon angazhimin në edukimin e brezave të rinj mbi rolin dhe vlerën e sigurimeve 12

3. ECURIA E BORXHIT QEVERITAR DHE ENORMAVE TË INTERESIT GJATË VITIT 2025
3.1. Menaxhimi dhe politikat e investimit 13
3.2. Tregu i pensioneve private vijoi rritjen edhe gjatë vitit 2025 14
3.3. Risitë e pritshme në tregun e fondeve të pensioneve për periudhën në vazhdim 15
3.4. Pritshmëritë për vitin 2026 16

4. ECURIA E FONDIT TË INVESTIMIT "ALBSIG STANDARD"
4.1. Objektivat dhe politika e investimit 17
4.1.1. Profili i riskut dhe përfitimit 17
4.1.2 Komisionet/tarifat e Fondit 17
4.1.3. Komisione dhe tarifa të tjera të vazhdueshme 18
4.1.4 Komisionet/tarifat të tjera të mbajtura nga Fondi 18
4.1.5. Norma Neto e Kthimit për "Albsig Standard" 2021-2025 18

5. ECURIA E FONDIT TË PENSIONIT ALBSIG
5.1. Politika e Investimit 19
5.1.1. Elementet kryesorë të politikës së investimit 19
5.1.2 Profili i riskut dhe përfitimit 19
5.1.3.Komisionet/tarifat e Fondit 19
5.1.4 Norma Neto e Kthimit për "Albsig Pension" 2021-2025 20

6. ECURIA E FONDIT TË PENSIONIT SMART PENSION
6.1. Politika e Investimit 21
6.1.1. Elementet kryesorë të politikës së investimit 21
6.1.2. Profili i riskut dhe përfitimit 21
6.1.3.Komisionet/tarifat e Fondit 21
6.1.4 Norma Neto e Kthimit për "Smart Pension" deri më 31.12.2024 22

7. PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR
7.1. Raporti i audituesve të pavarur 23
7.2. Pasqyra e pozicionit financiar 26
7.3. Pasqyra e fitim ose humbjeve dhe e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse 27
7.4. Pasqyra e flukseve monetare 28
7.5. Pasqyra e ndryshimeve në kapital 29

8. PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR
8.1. Raporti i audituesve të pavarur 30
8.2. Pasqyra e pozicionit financiar 33
8.3. Pasqyra e fitim ose humbjeve dhe e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse 34
8.4. Pasqyra e flukseve monetare 35
8.5. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto 36

9. PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR
9.1. Raporti i audituesve të pavarur 37
9.2. Pasqyra e pozicionit financiar 40
9.3. Pasqyra e fitim ose humbjeve dhe e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse 41
9.4. Pasqyra e flukseve monetare 42
9.5. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto 43

10. SMART PENSION
10.1. Raporti i audituesve të pavarur 44
10.2. Pasqyra e pozicionit financiar 47
10.3. Pasqyra e fitim ose humbjeve dhe e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse 48
10.4. Pasqyra e flukseve monetare 49
10.5. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto 50

MESAZH NGA ADMINISTRATORI I PËRGJITHSHËM

Të nderuar anëtarë dhe investitorë!

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj Raportin Vjetor për vitin financiar 2025, një vit që u karakterizua nga rritje e qëndrueshme, menaxhim i kujdesshëm i investimeve dhe përkushtim i vazhdueshëm për krijimin e vlerës afatgjatë për investitorët tanë.

Në emër të Albsig Invest, dëshiroj t'ju shpreh mirënjohjen time të sinqertë për besimin dhe mbështetjen që na keni dhënë ndër vite. Besimi juaj mbetet motivimi ynë kryesor për të zhvilluar produkte konkurruese, për të ruajtur standardet më të larta të profesionalizmit dhe për të siguruar menaxhim të përgjegjshëm të aseteve që na janë besuar.

Viti 2025 paraqiti mundësi të rëndësishme për tregun financiar shqiptar, të cilat Albsig Invest arriti t'i shfrytëzojë në mënyrë efikase falë një strategjie investimi të mirëstrukturuar dhe një qasjeje të disiplinuar ndaj menaxhimit të rrezikut. Në një mjedis ekonomik që kërkonte vëmendje dhe fleksibilitet, ne vazhduam të mbetemi të fokusuar në objektivin tonë themelor: ruajtjen dhe rritjen e vlerës së investimeve të klientëve tanë. Gjatë vitit 2025, shoqëria jonë vijoi të forcojë standardet e qeverisjes, transparencës dhe kontrollit të brendshëm, duke garantuar që çdo vendimmarrje të jetë në përputhje me interesat afatgjata të anëtarëve dhe investitorëve tanë. Rezultatet e arritura gjatë këtij viti konfirmojnë qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e modelit tonë të menaxhimit. Në fund të vitit 2025, Fondi i Pensionit Privat Albsig dhe Smart Pension numëronin gjithsej 5,515 plane pensioni aktive, duke reflektuar besimin në rritje të individëve dhe punëdhënësve ndaj produkteve tona të pensionit privat.

Fondi i Pensionit Privat Albsig realizoi një normë kthimi vjetore prej +4.12%, ndërsa Fondi i Pensionit Privat Smart Pension arriti një normë kthimi prej +5.05%, duke u renditur si fondi me performancën më të lartë në treg për vitin 2025. Ky rezultat pasqyron menaxhimin profesional të portofolit dhe aftësinë për të identifikuar mundësitë më të mira të investimit në kohën e duhur. Një tjetër tregues i rëndësishëm i suksesit tonë është rritja e Vlerës Neto të Aseteve të fondeve të pensionit Albsig dhe Smart Pension, e cila në fund të dhjetorit 2025 arriti në 1.07 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 28.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit pararendës.

Edhe Fondi i Investimit Albsig Standard vazhdoi të demonstrojë performancë pozitive gjatë vitit 2025, duke realizuar një normë kthimi prej +4.9%. Paralelisht, Vlera Neto e Aseteve (NAV) e fondit u rrit me 10.3% krahasuar me fillimin e vitit, duke reflektuar efektivitetin e strategjisë së investimit dhe menaxhimin e kujdesshëm të portofolit. Këto rezultate janë dëshmi e angazhimit të vazhdueshëm të ekipit tonë për të ofruar stabilitet, siguri dhe kthime konkurruese për investitorët tanë, duke ruajtur njëkohësisht standardet më të larta të integritetit dhe profesionalizmit.

Duke parë përpara, ne mbetemi të përkushtuar ndaj objektivave tona strategjike për të zgjeruar praninë në treg, për të zhvilluar produkte inovative dhe për të krijuar vlerë të qëndrueshme për të gjithë investitorët dhe anëtarët tanë. Jemi të bindur se me mbështetjen tuaj do të vazhdojmë të ndërtojmë histori suksesi dhe të forcojmë më tej pozicionin e Albsig Invest në tregun financiar shqiptar.

Ju falënderojmë për besimin dhe partneritetin tuaj të vazhdueshëm..

Elton Korbi,
Administrator i Përgjithshëm

1 SHOQËRIA ALBSIG INVEST SH.A.

Albsig Invest Sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, është një shoqëri aksionare, me seli në Rrugën e Barrikadave, Albsig HQ, Kati 8, Tiranë. Albsig Invest Sh.a është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 04.10.2019. Albsig Invest Sh.a është licensuar Shoqëria Administruese me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) nr. 210, datë 22.11.2019 "Për të vepruar si shoqëri administruese e fondeve të pensionit Privat në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit Privat dhe kryerjen e pagesave të pensionit, si dhe për administrimin e aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive" (Licensa nr. 5, datë 22.11.2019 pa afat). Me vendimin e mësipërm AMF miratoi edhe Fondin e Pensionit Privat Albsig.

Me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), nr. 255, datë 30.12.2019, u miratua Fondi i Investimit Albsig Standard. Me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), nr. 96, datë 28.04.2022., u miratua Fondi i Pensionit Privat "Smart Pension".

Albsig Invest Sh.a mbikëqyret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

1.1. Struktura e aksionerëve të shoqërisë administruese

- Aksioneri i vetëm i shoqërisë është Albsig Jetë Sh.a, i cili zotëron 100% të aksioneve.
- Shoqëria Administruese mund të ketë nën administrim një ose disa fonde pensioni dhe një ose disa fonde investimi ne të njëjtën kohë.
- Aktualisht Albsig Invest Sh.a ka nën administrim Fondin e Pensionit Privat Albsig, Fondin e Pensionit Privat "Smart Pension" dhe Fondin e Investimit Albsig Standard.

1.2. Objektivat e shoqërisë administruese

1. Mbledhja dhe investimi i fondeve të pensionit Privat si dhe kryerja e pagesave të pensionit;
2. Administrimi i fondeve të pensionit Privat dhe aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive.

1.3. Misioni dhe vlerat bazë

MISIONI

Ofrimi i alternativave të përshtatshme për investitorët, ku çdokush të mund të gjejë mënyrën e duhur të investimit, duke u mbështetur tek:

- Informimi dhe edukimi i investitorëve mbi investimin në fonde pensioni dhe fonde investimi;
- Këshillimi i klientëve dhe orientimi i tyre drejt vendimmarrjes së duhur të investimit;
- Menaxhim cilësor të aseteve me qëllim kthime të kënaqshme nga investimi;
- Qeverisje të mirë të korporatës dhe transparencë maksimale për investitorët;
- Krijimi i alternativave të ndryshme investimi me qëllim që çdo investitor të mund të gjejë mundësinë e kërkuar të investimit.

VIZIONI

Albsig Invest Sh.a synon dhënien e alternativave më të mira dhe të sigurta të investimit në tregun e kapitalit në Shqipëri.

1.4. Këshilli i administrimit

Këshilli i Administrimit është organi më i lartë i Shoqërisë Administruese i cili kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit të Shoqërisë Administruese. Ai kujdeset që Shoqëria Administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit, miraton politikat financiare, të investimit, Prospektin duke siguruar kështu administrimin e drejtë të Shoqërisë Administruese dhe përgjegjshmërinë kundrejt publikut për veprimet, angazhimin dhe rezultatet e saj. Këshilli përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë si më poshtë.



Z. Irfan LAMI

Kryetar i Këshillit të Administrimit

Z. Irfan Lami ka karrierë të gjatë në fushën financiare prej vitit 1995. Z. Lami ka eksperiencë disavjeçare pranë ISSH në fushën e pensioneve, financës dhe auditimit. Ka eksperiencë mbi 18 vjeçare në menaxhimin financiar dhe drejtues të shoqërive të sigurimeve në Shqipëri dhe Kosovë. Prej vitit 2015 është Drejtor i Departamentit të Financës të Shoqërisë Albsig Sh.a. Z. Lami zotëron diplomë universitare e integruar e nivelit të dytë në Financë nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, që nga viti 1995. Z. Lami ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit financiar dhe të riskut.



Z. Dritan KASTRATI

Anëtar i Këshillit të Administrimit

Z. Dritan Kastrati ka një eksperiencë disavjeçare pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, si specialist i trajtimit të dëmeve, sekretar i Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve/Komisioneve dhe administrimit të praktikave të BSHS. Z. Kastrati prej vitit 2015 është pjesë e Albsig Sh.a si Drejtor i Departamentit të Dëmeve dhe Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm. Z. Kastrati zotëron diplomë master në Administrim Publik nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës. Z. Kastrati ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit (publik dhe të shoqërive private), të sigurimeve, trajtimit të dëmeve dhe riskut.



Z. Elvis BEQIRI

Anëtar i Këshillit të Administrimit

Z. Elvis Beqiri prej vitit 2017 është pjesë e shoqërisë Albsig Sh.a si Drejtor i Sigurimit të Përgjegjësive. Z. Beqiri ka një eksperiencë 14 vjeçare në fushën bankare në pozicione të ndryshme si Drejtor Departamenti, Drejtues Dege, etj. Z. Beqiri zotëron diplomë master në Administrim Biznesi (MBA) nga Universiteti Polis dhe IPAG Business School, Paris. Z. Beqiri ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit dhe financiare.



Z. Elton KORBI

Anëtar Ekzekutiv i Këshillit të Administrimit

Z. Elton Korbi është aktualisht Administrator i Përgjithshëm i Albsig Invest Sh.a. Z. Korbi ka një eksperiencë mbi 13 vjeçare në sektorin bankar në banka tregtare dhe në Bankën e Shqipërisë, në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, kontabilitetit dhe analizës financiare. Z. Korbi zotëron diplomë universitare të integruar të nivelit të dytë në Financë nga Universiteti i Tiranës si dhe diplomë master në Administrim Biznes (MBA) nga Universiteti Epoka. Z. Korbi nga viti 2015 është duke ndjekur studimet për marrjen e certifikatës ACCA (Association of Chartered Certified Accountants). Z. Korbi ka zhvilluar trajnime të shumta në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, menaxhimit të riskut, menaxhimit financiar dhe buxhetimit nga institucione prestigjioze si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Deutsche Bundesbank, BaFIN, Banque de France, etj..



Z. Admir RAMADANI

Anëtar Ekzekutiv i Këshillit të Administrimit

Z. Admir Ramadani është aktualisht Drejtor i Investimeve dhe Zëvendës Administrator i Përgjithshëm i Albsig Invest Sh.a. Z. Ramadani ka një eksperiencë 13 vjeçare në sektorin bankar, nga të cilat 5 vjet në fushën e investimeve si dhe 8 vite në fushën e menaxhimit të risqeve. Z. Ramadani zotëron dy diploma në Ekonomi dhe Matematikë nga Universiteti Amerikan në Bullgari. Z. Ramadani zotëron titullin CFA (Chartered Financial Analyst) që nga Tetor 2012.

1.5. Kodi i etikës

Kodi i Etikës është krijuar për të drejtuar etikën personale dhe profesionale të Shoqërisë Administruese. Ai përbëhet nga një set normash dhe rregullash që rregullojnë marrëdhëniet e përditshme të Shoqërisë Administruese. Ai është i zbatueshëm nga të gjithë punonjësit e Shoqërisë Administruese dhe pranë çdo filiali/dege/agjencie të saj. Veç kësaj, personat e tjerë që kryejnë shërbime për Shoqërinë Administruese i nënshtrohen Kodit të Etikës nëpërmjet kontratës apo marrëveshjes. Të gjithë kanë përgjegjësi për të kontribuar dhe për të ndihmuar në mbajtjen dhe ruajtjen e reputacionit të mirë të Shoqërisë për ndershmëri, përkushtim, korrektesë, paanshmëri dhe integritet.

1.6 Transparenca

Transparenca është një nga parimet e shtuara që Albsig Invest e ka ndjekur që nga nisja e aktivitetit si një nga bazat më të rëndësishme për të krijuar urat lidhëse midis shoqërisë dhe klientëve, punonjësve, partnerëve si dhe regullatorëve të saj.mShoqëria ka qenë dhe do të jetë gjithmonë transparente më të gjithë bashkëpuntorët e saj në dhënien e informacioneve të plota dhe të sakta lidhur me produktet që ofron. Shoqëria mban të informuar në mënyrë të vazhdueshme klientët e saj në lidhje me ecurinë e fondeve, tarifat që aplikohen si dhe rrisqet që mbart secili fond. Çdo ditë shoqëria përllogarit dhe publikon çmimet dhe Vlerën Neto të Aseteve në faqen e saj të web-it: www.albsiginvest.al.

Gjithashtu çdo klient pajiset me kredencialet e tij personale si Përdorues dhe Fjalëkalim, ku nëpërmjet tyre mund të monitoroj llogarinë e tij personale 24/7. Nëpëmjet platformës Selfcare klienti informohet për balancën e tij, trasaksionet, ecurinë e fondit si dhe mund të gjeneroj certifikatën e pronësisë së kuotave. Të gjitha publikimet dhe raportet financiare dhe vjetore të Shoqërisë Administruese Albsig Invest dhe të fondeve që shoqëria ka nën administrim janë të disponueshme dhe mund të shfletohen elektronikisht në faqen zyrtare www.albsiginvest.al.

2 PËRGJEGJËSIA SOCIALE

2.1. Simultane Shahu dhe Ping Pong në Maarif

Për të qenë gjithmonë më pranë klientëve tanë, ALBSIG ka zgjeruar rrjetin e degëve me një pikë të re shërbimi në një nga zonat më të frekuentuara të kryeqytetit — Pallati me Shigjeta. Kjo degë moderne do të ofrojë të gjitha shërbimet e sigurimit, me të njëjtin profesionalizëm, shpejtësi dhe korrektësi që na karakterizon. Stafi i përgatitur dhe ambienti mikpritës e bëjnë këtë degë një tjetër hap konkret drejt qëllimit tonë: t'i japim çdo klienti një eksperiencë të kënaqshme dhe të sigurt në çdo ndërveprim me ALBSIG.







2.2. Një ditë në ALBSIG dhe ALBSIG INVEST, Aleksandra dhe Melisa pjesë e projektit "Drejtues për një ditë" nga Junior Achievement of Albania

Në mbështetje të programit "Drejtues për një ditë" nga Junior Achievement of Albania, ishin me ne në Albsig, Aleksandra Brami dhe Melisa Lazi. Gjimnazistet u bënë pjesë e stafit drejtues të kompanisë për një ditë, u njohën me drejtuesit e kompanisë dhe njëkohësisht panë më nga afër të gjithë punën e departamenteve të shoqërisë Albsig dhe Albsig Invest. Melisa ka qëndruar përgjatë një dite në Departamentin e Marketingut dhe ka parë më nga afër punën e këtij departamenti, ndërkohë që Aleksandra shoqëroi Z. Elton Korbi, Drejtor i Përgjithshëm i Albsig Invest në angazhimet dhe takimet e ditës. Besojmë se nisma të tilla janë thelbësore për të ndërtuar ura të forta mes edukimit dhe tregut të punës. Të rinjtë kanë nevojë për më shumë eksperienca reale, mentorim profesional dhe ekspozim ndaj sfidave të punës së përditshme, në mënyrë që të formësojnë më qartë aspiratat dhe aftësitë e tyre.



2.3 ALBSIG dhe ALBSIG INVEST në Panairin e Karrierës të Western Balkans University



Western Balkans University, në bashkëpunim me Dhomën Britanike të Tregtisë në Shqipëri, organizoi edicionin e dytë të Panairit të Karrierës, që solli së bashku mbi 60 biznese dhe institucione për t'u ofruar studentëve një pasqyrë reale të botës së punës. Albsig, pjesë e Kastrati Group, ishte krenare të ishte pjesë e këtij aktiviteti, duke sjellë në stendën e saj eksperiencën dhe energjinë e një ekipi të përkushtuar. Studentët e WBU u treguan mjaft të interesuar për mundësitë e internshipeve dhe bashkëbiseduan me ekspertët tanë për të kuptuar më mirë si mund të integrohen në tregun e punës. Për shumë prej tyre, ky panair ishte një hap i parë i rëndësishëm drejt një karriere të suksesshme. Albsig, si gjithmonë, mbështet iniciativat që nxisin zhvillimin profesional të të rinjve dhe i orienton ata drejt mundësive konkrete për praktikë dhe punësim. .

2.4. ALBSIG dhe ALBSIG INVEST organizon një ditë dhurimi gjaku në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar

Në kuadër të angazhimit të vazhdueshëm për përgjegjësi sociale dhe mbështetje ndaj komunitetit, ALBSIG organizoi në ambientet e drejtorisë qendrore një aktivitet dedikuar dhurimit vullnetar të gjakut, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar. Nën moton "Dhuro gjak, shpëto jetë", punonjës të kompanisë u bënë pjesë aktive e një procesi jetik për sistemin shëndetësor në vend. Dhurimi i gjakut është një ndër aktet më domethënëse të solidaritetit dhe një nevojë e vazhdueshme për trajtimin e pacientëve që përballen me emergjenca mjekësore, ndërhyrje kirurgjikale, apo sëmundje kronike.





Përmes kësaj iniciative, ALBSIG synon të përçojë mesazhin se secili prej nesh mund të bëjë një ndryshim të vërtetë në jetën e dikujt, me një akt të thjeshtë, por me ndikim të madh. Nisma është pjesë e kalendarit të veprimtarive të kompanisë që mbështesin kauza sociale dhe kontribuojnë në mirëqenien kolektive. Ne e shohim përgjegjësinë sociale jo thjesht si pjesë të identitetit tonë korporativ, por si një detyrim moral për të qenë pranë komunitetit në momente dhe forma që kanë rëndësi reale. Bashkëpunimi me Kryqin e Kuq Shqiptar ka qenë thelbësor për realizimin e kësaj dite, duke siguruar standardet e duhura mjekësore, ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e stafit në një atmosferë organizative shembullore.

ALBSIG mbetet e angazhuar për të vijuar mbështetjen e kauzave që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës në shoqëri, duke fuqizuar rolin e saj si një kompani që kujdeset jo vetëm për sigurinë financiare, por edhe për jetën.

2.5 ALBSIG dhe ALBSIG INVEST në Samitin Ekonomik Shqipëri—Turqi: Një hap i ri drejt forcimit të partneritetit strategjik dhe zhvillimit të qëndrueshëm

Shoqëria e Sigurimeve ALBSIG mori pjesë në hapjen e Samitit Ekonomik Shqipëri—Turqi, organizuar nga MÜSİAD Albania, një aktivitet i rëndësishëm që vuri në qendër bashkëpunimin strategjik ndërmjet dy vendeve në fushat e turizmit, kulturës dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Ky forum shënon një tjetër hap përpara në forcimin e marrëdhënieve ekonomike mes Shqipërisë dhe Turqisë, duke krijuar mundësi të reja për investime, shkëmbime tregtare dhe bashkëpunime afatgjata, veçanërisht në sektorin e turizmit, një nga motorët kryesorë të zhvillimit të ekonomisë shqiptare.

Ngjarja mblodhi përfaqësues të bizneseve, institucioneve dhe qeverive nga të dy vendet, të cilët ndanë vizionin e përbashkët për forcimin e urave ekonomike dhe kulturore që lidhin Shqipërinë dhe Turqinë. Në qendër të diskutimeve u theksua rëndësia e partneriteteve të qëndrueshme, që nxisin zhvillimin ekonomik, turizmin cilësor dhe inovacionin në të dy tregjet.

Një pjesë e rëndësishme e Samitit ishte Albania—Türkiye Investment Forum 2025, ku u zhvilluan takime B2B mes dhjetëra bizneseve shqiptare dhe turke. Këto takime krijuan hapësirën e duhur për shkëmbim idesh, ndërtim partneritetesh të reja dhe konkretizim projektesh të përbashkëta, duke e kthyer bashkëpunimin në veprim real.



Energjia pozitive, kontaktet e reja dhe iniciativat që morën jetë gjatë forumit treguan se e ardhmja e bashkëpunimit ekonomik mes Shqipërisë dhe Turqisë është më afër se kurrë. Pjesëmarrja e ALBSIG në këtë samit përforcon angazhimin e shoqërisë për të qenë pjesë aktive e dialogut ekonomik rajonal, duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe krijimin e mundësive të reja për investime. Si pjesë e Grupit Kastrati, ALBSIG ndan të njëjtin vizion për bashkëpunim ndërkombëtar, inovacion dhe integrim ekonomik, duke kontribuar në forcimin e partneriteteve që sjellin vlerë të shtuar për bizneset dhe komunitetin.

Ky samit përfaqëson jo vetëm një platformë bashkëpunimi ekonomik, por edhe një urë miqësie dhe zhvillimi të qëndrueshëm midis dy vendeve që ndajnë histori, kulturë dhe vizion të përbashkët për të ardhmen.



2.6 ALBSIG dhe ALBSIG INVEST për Tetorin Rozë. Kujdes, ndërgjegjësim dhe mbështetje — sepse shëndeti fillon me kujdesin ndaj vetes

Në kuadër të Tetorit Rozë dhe si pjesë e traditës së përvitshme të ALBSIG, janë mundësuar kontrolle falas për eko gjiri pranë Klinikës Wellness për të gjitha koleget e shoqërisë. Kjo nismë vjen si pjesë e angazhimit të ALBSIG për të mbështetur ndërgjegjësimin mbi parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit, një kauzë me rëndësi të veçantë për komunitetin dhe shëndetin e grave.

Për ALBSIG, kujdesi ndaj shëndetit nuk është vetëm përgjegjësi personale, por një vlerë që përqafojmë së bashku. Kjo mundësi e ofruar për stafin tonë është shprehje e bindjes se parandalimi dhe kontrolli i rregullt janë hapat më të rëndësishëm drejt shëndetit dhe jetës së sigurt.

Çdo vit, ALBSIG e përforcon këtë traditë si shenjë solidariteti, kujdesi dhe mbështetjeje, duke kujtuar se shëndeti i çdo gruaje është një prioritet që na bashkon të gjithëve. Sepse në ALBSIG, kujdesi është pjesë e kulturës sonë — dhe çdo hap i vogël për shëndetin, është një hap i madh për jetën. Tetori është muaji i ndërgjegjësimit për luftën kundër kancerit të gjirit, një kauzë që çdo vit na kujton rëndësinë e kujdesit, kontrollit dhe parandalimit. Në kuadër të Tetorit Rozë, ALBSIG zhvillon një fushatë ndërgjegjësimi me moton: "Në ndihmë të vajzave dhe grave për diagnostikimin sa më të hershëm të çdo problematike shëndetësore, me fokus në kancerin e gjirit." Ky muaj mbart një mesazh të fortë solidariteti dhe kujdesi, duke ftuar çdo vajzë e grua të marrë kohën për t'u informuar dhe për të bërë kontrollet periodike. Parandalimi dhe diagnostikimi i hershëm shpëtojnë jetë.

Në shenjë sensibilizimi dhe mbështetjeje, ALBSIG — pjesë e Kastrati Group — bashkohet edhe këtë vit me fushatën Tetori Rozë, duke qenë përkrah çdo gruaje në këtë betejë të rëndësishme për shëndetin dhe jetën.

Sepse shëndeti është pasuria më e çmuar, dhe kujdesi për veten është hapi i parë drejt një të ardhmeje të sigurt. Ne në ALBSIG besojmë se siguria nuk kufizohet vetëm te pasuritë dhe asetet materiale — ajo fillon nga shëndeti.

Prandaj, ju inkurajojmë që gjatë këtij muaji të bëni kontrollin e gjirit dhe ta bëni këtë një pjesë të zakonshme të kujdesit tuaj personal

2.7 ALBSIG dhe ALBSIG INVEST forcon angazhimin në edukimin e brezave të rinj mbi rolin dhe vlerën e sigurimeve

Në kuadër të misionit të saj për të promovuar kulturën e sigurimit dhe për të mbështetur zhvillimin profesional të të rinjve, ALBSIG ka intensifikuar aktivitetet e bashkëpunimit me institucione arsimore, duke krijuar ura komunikimi dhe edukimi që synojnë ndërtimin e një gjenerate më të informuar, më të ndërgjegjshme dhe më të përgatitur për tregun e punës.

Vizita e studentëve të Turgut Ozal në Drejtorinë Qendrore të ALBSIG

ALBSIG mirëpriti në ambientet e saj një grup studentësh nga Turgut Ozal, të cilët patën mundësinë të njihen nga afër me funksionimin e Shoqërisë dhe rolin e sigurimeve në jetën e përditshme. Përfaqësues nga departamente të ndryshme prezantuan informacione të vlefshme mbi rëndësinë e sigurimeve si element që garanton stabilitet financiar për individët dhe bizneset, si dhe ndikimin që kjo industri ka në zhvillimin e ekonomisë. Gjatë takimit u theksuan gjithashtu mundësitë e shumta që ALBSIG ofron si partner i besueshëm për mbrojtjen financiare në çdo etapë të jetës, duke i orientuar studentët mbi rëndësinë e njohurive rreth këtij sektori për të ardhmen e tyre profesionale.

Angazhimi i ALBSIG me Shkollën Teknike Ekonomike Tiranë

Në vijim të përpjekjeve për të kontribuar në edukimin financiar të brezave të rinj, stafi i ALBSIG zhvilloi një vizitë në Shkollën Teknike Ekonomike Tiranë, ku gjatë një ore të hapur u diskutua gjerësisht mbi fushën e sigurimeve dhe rolin që ajo luan në ekonominë moderne. Nxënësit u informuan mbi mundësitë e shumta të zhvillimit profesional në këtë sektor, si dhe mbi vlerat dhe standardet që ALBSIG përfaqëson në treg. Krahas prezantimit teorik, ALBSIG ka mundësuar edhe trajnim praktik për nxënësit e kësaj shkolle në degët e saj, duke u ofruar atyre një eksperiencë reale mbi proceset e punës, ndërveprimin me klientët dhe detyrat e përditshme që karakterizojnë aktivitetin e një kompanie sigurimesh. Kjo iniciativë përbën një kontribut të drejtpërdrejtë në ndërtimin e kompetencave profesionale të të rinjve.

Studentët e Universitetit Epoka vizitojnë Departamentin e Marketingut të ALBSIG

Një tjetër aktivitet i rëndësishëm u zhvillua me studentët e degës Marketing pranë Universitetit Epoka, të cilët në kuadër të projektit të tyre për studimin e tregut zgjodhën ALBSIG për të marrë një pasqyrë konkrete dhe profesionale mbi funksionimin e marketingut në industrinë e sigurimeve. Ekipi i Marketingut të ALBSIG i mirëpriti me kënaqësi studentët, duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre dhe duke i prezantuar me praktikat më të mira të komunikimit, ndërtimit të strategjive promovuese në një treg dinamik dhe konkurrues. Kjo vizitë u shndërrua në një eksperiencë frymëzuese që ndërthur dijen teorike me praktikën, si dhe kuriozitetin me vizionin për një të ardhme të sigurt profesionale.

Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, ALBSIG riafirmon angazhimin e saj për të investuar në edukimin dhe zhvillimin e të rinjve, duke kontribuar në krijimin e një kulture të qëndrueshme sigurimesh në vend. Shoqëria mbetet e palëkundur në misionin e saj për të ndarë njohuri, për të ofruar mbështetje dhe për të mbështetur talentet e reja që do të jenë profesionistët e së nesërmes.



3 ECURIA E BORXHIT QEVERITAR DHE E NORMAVE TË INTERESIT GJATË VITIT 2025

Banka e Shqipërisë vijon politikën lehtësuese monetare gjatë vitit 2025.
Viti 2025 u karakterizua nga stabilitet makroekonomik, rritje e qëndrueshme ekonomike dhe presione inflacioniste të kontrolluara. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë vijoi politikën monetare lehtësuese me qëllim mbështetjen e aktivitetit ekonomik dhe kthimin e qëndrueshëm të inflacionit pranë objektivit të saj afatmesëm.

Ulja e normës bazë të interesit
Gjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë ndërmori një tjetër hap në drejtim të lehtësimit të politikës monetare, duke ulur normën bazë të interesit nga 2.75% në 2.50% në muajin korrik. Pas këtij vendimi, norma bazë mbeti e pandryshuar deri në fund të vitit, duke reflektuar vlerësimin e Bankës së Shqipërisë se kushtet monetare ishin të përshtatshme për ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe financiar.

Inflacioni dhe zhvillimet ekonomike
Gjatë vitit 2025, inflacioni vijoi të mbetet i kontrolluar dhe pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Rritja ekonomike u mbështet nga zgjerimi i konsumit privat, investimeve dhe aktivitetit në sektorin e turizmit, ndërsa tregu i punës vazhdoi të shfaqë tregues pozitivë. Këto zhvillime krijuan kushte të favorshme për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe forcimin e besimit të investitorëve.

Ecuria e normave të interesit të titujve qeveritarë
Në përputhje me politikën monetare lehtësuese dhe pritshmëritë për inflacion të moderuar, gjatë vitit 2025 normat e interesit të titujve të borxhit qeveritar vijuan tendencën rënëse të nisur në vitet e mëparshme. Yield-et e bonove të thesarit dhe obligacioneve të qeverisë shqiptare u stabilizuan në nivele më të ulëta, duke reflektuar kërkesën e lartë të investitorëve për instrumente me rrezik të ulët dhe përmirësimin e kushteve të financimit në tregun e brendshëm. Rënia e normave të interesit ka ndikuar pozitivisht në vlerësimin e portofolave të investuar në bono dhe obligacione qeveritare, duke krijuar kushte të favorshme për fondet e pensionit dhe fondet e investimit që operojnë në tregun vendas.

Perspektiva për investitorët
Mjedisi i normave më të ulëta të interesit gjatë vitit 2025 ka vazhduar të mbështesë performancën e investimeve në titujt qeveritarë ekzistues, ndërsa ka krijuar mundësi për diversifikimin e portofolave dhe optimizimin e strategjive të investimit. Në këtë kuadër, fondet e administruara nga Albsig Invest kanë vijuar të përfitojnë nga menaxhimi aktiv i portofolit dhe nga pozicionimi i kujdesshëm ndaj zhvillimeve të tregut.

Në tërësi, viti 2025 konfirmoi stabilitetin e tregut financiar shqiptar dhe efektivitetin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në mbështetje të rritjes ekonomike dhe kontrollit të inflacionit. Këto zhvillime krijuan një mjedis të favorshëm për investitorët dhe kontribuuan në ruajtjen e performancës pozitive të fondeve të pensionit dhe investimit.

3.1 Menaxhimi dhe politikat e investimit

Në vazhdën e angazhimit të saj për promovimin e një stili jetese të shëndetshme dhe për mbështetjen e aktiviteteve sportive, ALBSIG mori pjesë në Kampionatin e Biznesit të Federatës Shqiptare të Ping Pongut. Ky event, i cili mblodhi kompani të ndryshme nga sektori privat, ishte një mundësi e shkëlqyer për të forcuar marrëdhëniet midis bizneseve dhe për të promovuar rëndësinë e aktivitetit fizik në ambientet e punës. Ekipi i ALBSIG u përfaqësua me një performancë të shkëlqyer, duke reflektuar jo vetëm frymën sportive, por edhe angazhimin e kompanisë për të ndërtuar një komunitet biznesi të shëndetshëm dhe të lidhur. Ky event tregoi se sporti dhe biznesi mund të ecin paralelisht, duke sjellë përfitime për të gjithë pjesëmarrësit.

3.2 Tregu i pensioneve private vijoi rritjen edhe gjatë vitit 2025.

Viti 2025 shënoi një tjetër periudhë zhvillimi për tregun e pensioneve private në Shqipëri, duke konfirmuar rritjen e vazhdueshme të interesit të individëve dhe punëdhënësve për kursimin afatgjatë dhe sigurimin e të ardhurave shtesë për periudhën e pensionit.

Sipas të dhënave të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), tregu i pensioneve private vijoi trendin pozitiv të viteve të fundit, si në aspektin e zgjerimit të bazës së anëtarëve, ashtu edhe në rritjen e aseteve nën administrim. Në fund të vitit 2025, vlera neto e aktiveve të tregut të fondeve të pensionit privat arriti në rreth 9.86 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 21.55% krahasuar me fundin e vitit 2024. Në të njëjtën kohë, numri i anëtarëve në fondet e pensionit privat arriti në 49,218, ose 11.19% më shumë se një vit më parë. Gjatë vitit 2025, në tregun shqiptar operuan shtatë fonde pensioni private të administruara nga katër shoqëri administruese, ndërsa një fond i ri nisi aktivitetin gjatë vitit, duke reflektuar interesin në rritje për këtë segment të tregut financiar.

Një karakteristikë e rëndësishme e tregut të pensioneve private mbeti orientimi i investimeve drejt instrumenteve me nivel të ulët risku. Investimet e fondeve të pensionit arritën në 9.49 miliardë lekë, ku rreth 96% e portofolit ishte e investuar në obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Ky pozicionim pasqyron natyrën konservatore të fondeve të pensionit dhe objektivin e tyre kryesor për ruajtjen e kapitalit dhe sigurimin e kthimeve të qëndrueshme në afat të gjatë. Zhvillimet e tregut gjatë vitit 2025 konfirmuan edhe një herë rëndësinë e titujve të borxhit qeveritar si instrumenti kryesor i investimit për fondet e pensionit privat. Stabiliteti i tregut të obligacioneve shtetërore dhe menaxhimi i kujdesshëm i portofolave kanë krijuar kushte të favorshme për realizimin e objektivave afatgjata të kursimit dhe investimit të anëtarëve të fondeve të pensionit.



Në këtë mjedis pozitiv, fondet e pensionit të administruara nga Albsig Invest vijuan të kontribuojnë në zhvillimin e tregut, duke ofruar alternativa të sigurta dhe konkurruese për kursimin afatgjatë. Rritja e numrit të anëtarëve, zgjerimi i aseteve nën administrim dhe performanca pozitive e fondeve konfirmojnë besimin në rritje të investitorëve ndaj pensioneve private si një instrument i rëndësishëm për garantimin e sigurisë financiare në të ardhmen.

3.3 Risitë e pritshme në tregun e fondeve të pensioneve për periudhën në vazhdim.

Tregu i pensioneve private në Shqipëri ka shfaqur një zhvillim të qëndrueshëm gjatë viteve të fundit, duke reflektuar rritjen e ndërgjegjësimit të individëve dhe punëdhënësve për rëndësinë e kursimit afatgjatë. Rritja e vazhdueshme e numrit të anëtarëve dhe e aktiveve nën administrim pritet të shoqërohet me ndryshime të mëtejshme që do të kontribuojnë në modernizimin dhe zgjerimin e këtij tregu.



Një nga zhvillimet më të rëndësishme të pritshme lidhet me zgjerimin e produkteve të pensionit privat dhe përshtatjen e tyre me nevojat e grupeve të ndryshme të klientëve. Shoqëritë administruese pritet të ofrojnë zgjidhje gjithnjë e më fleksibël, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes në skemat e pensioneve private dhe krijimin e alternativave të përshtatshme për individët, bizneset dhe profesionistët e pavarur.

Paralelisht, digjitalizimi i shërbimeve financiare pritet të luajë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në zhvillimin e sektorit.

Platforma online për monitorimin e llogarive individuale, aksesimi i informacionit në kohë reale dhe automatizimi i proceseve të administrimit do të rrisin transparencën dhe do të përmirësojnë përvojën e anëtarëve të fondeve të pensionit. Një tjetër drejtim i rëndësishëm është forcimi i edukimit financiar dhe promovimi i kulturës së kursimit afatgjatë. Me rritjen e pritshmërive për përfitime pensioni më të qëndrueshme në të ardhmen, pensionet private po konsiderohen gjithnjë e më shumë si një komponent i rëndësishëm i planifikimit financiar personal. Kjo pritet të nxisë zgjerimin e bazës së anëtarëve dhe rritjen e kontributeve në fondet ekzistuese.

Në aspektin e investimeve, fondet e pensionit do të vijojnë të mbështeten kryesisht në instrumente me profil të ulët rreziku, si titujt e borxhit qeveritar, ndërkohë që zhvillimi gradual i tregut financiar shqiptar mund të krijojë mundësi të reja për diversifikimin e portofolave. Një treg më i zhvilluar kapitalesh do t'u mundësonte fondeve të pensionit të optimizonin më tej raportin ndërmjet riskut dhe kthimit, duke ruajtur gjithmonë sigurinë e kursimeve të anëtarëve.

Gjithashtu, harmonizimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor dhe rregullator me standardet europiane pritet të kontribuojë në forcimin e mbrojtjes së investitorëve, rritjen e transparencës dhe zgjerimin e besimit të publikut ndaj skemave të pensioneve private.

Në këtë mjedis zhvillimi, Albsig Invest do të vazhdojë të mbetet e fokusuar në ofrimin e produkteve konkurruese, menaxhimin profesional të aktiveve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve për anëtarët e fondeve të pensionit. Objektivi ynë mbetet krijimi i vlerës së qëndrueshme afatgjatë dhe mbështetja e klientëve në ndërtimin e një të ardhmeje financiare më të sigurt.

Zhvillimet e pritshme në vitet e ardhshme tregojnë se tregu i pensioneve private në Shqipëri ka potencial të konsiderueshëm rritjeje dhe do të vazhdojë të luajë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në sistemin financiar dhe në mirëqenien afatgjatë të qytetarëve.

3.4 Pritshmëritë për vitin 2026

Pas rezultateve pozitive të arritura gjatë vitit 2025, pritshmëritë për vitin 2026 mbeten optimiste për tregun e pensioneve private dhe industrinë e administrimit të aktiveve në Shqipëri. Rritja e vazhdueshme e numrit të anëtarëve, zgjerimi i aktiveve nën administrim dhe përmirësimi i kuadrit rregullator pritet të mbështesin zhvillimin e mëtejshëm të sektorit dhe forcimin e rolit të tij në sistemin financiar shqiptar.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme të pritshme gjatë vitit 2026 lidhet me procesin e përafrimit të plotë të legjislacionit shqiptar të pensioneve private me Direktivën Evropiane IORP II, në kuadër të integrimit evropian të vendit. Ndryshimet e propozuara në ligjin për fondet private të pensioneve synojnë të forcojnë standardet e qeverisjes së brendshme, administrimit të rrezikut, kontrollit të brendshëm dhe transparencës ndaj anëtarëve dhe përfituesve të fondeve.

Pritet që këto ndryshime të kontribuojnë në rritjen e besimit të publikut ndaj pensioneve private, duke siguruar standarde më të larta mbrojtjeje për anëtarët dhe një nivel më të lartë transparence mbi performancën, kostot, politikat e investimit dhe përfitimet e pritshme të pensionit. Gjithashtu, kuadri i ri pritet të krijojë baza më të forta për zhvillimin afatgjatë të industrisë dhe për zgjerimin e pjesëmarrjes në skemat e pensioneve private.

Nga pikëpamja e investimeve, titujt e borxhit qeveritar pritet të vijojnë të mbeten instrumenti kryesor i investimit për fondet e pensionit dhe fondet e investimit, falë nivelit të lartë të sigurisë dhe stabilitetit që ofrojnë. Në të njëjtën kohë, zhvillimi gradual i tregjeve financiare dhe përmirësimi i infrastrukturës së tregut mund të krijojnë mundësi të reja për diversifikimin e portofolave, duke ruajtur njëkohësisht profilin konservator të investimit që karakterizon fondet e pensionit.

Për Albsig Invest, viti 2026 do të fokusohet në konsolidimin e mëtejshëm të pozicionit në treg, zgjerimin e bazës së anëtarëve dhe rritjen e aktiveve nën administrim. Shoqëria do të vijojë të ndjekë një strategji investimi të kujdesshme, të bazuar në menaxhimin profesional të rrezikut dhe krijimin e vlerës së qëndrueshme afatgjatë për investitorët dhe anëtarët e fondeve që administron. Një prioritet i rëndësishëm do të mbetet gjithashtu përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ndaj klientëve, digjitalizimi i proceseve operacionale dhe forcimi i komunikimit me anëtarët, me qëllim rritjen e transparencës dhe përmirësimin e përvojës së tyre.

Në tërësi, perspektiva për vitin 2026 mbetet pozitive. Mbështetur në stabilitetin e tregut financiar, zhvillimet rregullatore dhe rritjen e interesit për kursimin afatgjatë, tregu i pensioneve private pritet të vazhdojë zgjerimin e tij, duke luajtur një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në sigurinë financiare të qytetarëve dhe në zhvillimin e tregut të kapitaleve në Shqipëri.

4 ECURIA E FONDIT TË INVESTIMIT "ALBSIG STANDARD"

Fondi Investimit Albsig Standard është një Sipërmarrje Investimesh Kolektive (SIK), e veçantë me pjesëmarrje të hapur e cila administrohet nga shoqëria administruese "Albsig Invest sh.a.".

4.1 Objektivat dhe politika e investimit

Albsig Standard investon kryesisht në bono dhe obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të emetuara në Lekë, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat tregtare në Shqipëri. Objektivi i investimit është rritje e të ardhurave duke ruajtur principalin dhe likuiditetin. Fondi për të arritur diversifikimin mund të investojë deri në 10% në tituj borxhi të transferueshëm të kompanive apo njësive vendore me seli në Republikën e Shqipërisë por këto investime nuk ndikojnë mbi tolerancën e ulët për rrezik që ka Fondi. Investitori mund të shlyej të gjithë kuotat apo një pjesë të tyre sipas kërkesës në çdo kohë mbas investimit fillestar pa prishur normën e kthimit të realizuar deri në atë periudhë. Fondi i Investimit Albsig Standard nuk mbështet në një tregues referencë (benchmark) të caktuar.
Të ardhurat nga Fondi ri-investohen dhe nuk shpërndahen. Kostot e transaksioneve të portofolit nuk kanë një ndikim material mbi performancën e fondit. Rekomandohet që afati për investimin në Fond të jetë të paktën 2 vjet. Performanca e fondit ndikohet kryesisht nga ecuria e normave të interesit të letrave të borxhit të Republikës së Shqipërisë. Fondi investon vetëm në klasat e aseteve të përmendura më sipër dhe nuk lejon zgjedhje të lira në lidhje me investime të veçanta të lejueshme.

4.1.1. Profili i riskut dhe përfitimit

Risk i ulët						**Risk i lartë**
Përfitime zakonisht të ulëta					**Përfitime zakonisht të larta**	
1	2	3	4	5	6	7

Fondi i Investimit Albsig Standard ka një indikator risku në nivelin 3, pra të ulët, por nuk do të thotë që investimi është pa rrezik. Kategoria 3 përbën një risk sintetik i cili llogaritet duke u bazuar në luhatshmërinë e Fondit. Luhatshmëria e lartë ka një indikator risku më të lartë dhe një luhatshmëri më e ulët ka një indikator risku më të ulët. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nëpërmjet një rregullore specifike përcakton lidhjen midis luhatshmërisë së fondit dhe indikatorit të riskut sintetik. Për shkak se kjo kategori sintetike përdor të dhënat historike, treguesi sintetik mund të ndryshojë në të ardhmen por ky ndryshim parashikohet të jetë i rrallë. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit sintetik mund të mos jenë të dhëna relevante për profilin e ardhshëm të riskut të Fondit të Investimit Albsig Standard.

Risqet që nuk janë të përmbledhura në kategorinë e riskut sintetike janë: risku i kreditit, risku likuiditetit, risku operacional, risku i palës tjetër. Risku i kreditit mund të ndodh kur emetuesi i ndonjë bono apo obligacioni nuk është i gatshëm të paguaj interesin apo principalin në kohë. Bonot dhe Obligacionet zotërojnë një spektër gradash që përfaqësojnë riskun e kredisë. Fondi do investoi kryesisht në letra borxhi të Republikës së Shqipërisë dhe është lidhur ngushtë me aftësitë paguese të Shtetit Shqiptar. Risku i likuiditetit lidhet me faktin se obligacionet dhe bonot e Republikës së Shqipërisë nuk mund të tregtohen në çdo kohë apo do tregtohen me çmime jo të favorshme. Risku Operacional lind nga gabime të sistemeve ose gabime njerëzore të shoqërisë administruese. Risku i palës tjetër ndodh kur një pagesë të mos kryhet apo të kryhet me vonesë në një sistem transfertash për shkak të moszbatimit të kushteve të paracaktuara.

4.1.2 Komisionet/tarifat e Fondit

Komisionet/tarifat që investitori paguan përdoren për të shlyer kostot e administrimit të Fondit të Investimit Albsig Standard. Këto komisione ulin rritjen e mundshme të investimit. Komisionet dhe tarifat mund të jenë subjekt ndryshimi.

- Komisione/tarifa të njëhershme përpara ose pas investimit

- Komisioni/tarifa e hyrjes - 0 %
- Komisioni/tarifa i/e shlyerje - 0 %
- Komisionet/tarifat të vazhdueshme që mbahen nga Fondi gjatë periudhës së një viti
- Komisioni/tarifa vjetore e administrimit të Fondit — deri në 1%


4.1.3. Komisione dhe tarifa të tjera të vazhdueshme

- Tarifa e auditimit vjetor të fondit është sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese.
- Tarifa e depozitarit - 0.13% në vit e VNA
- Tarifa e AMF - 0.05% në vit e vlerës së përgjithshme të aseteve
- Tarifa e kostos së vazhdueshme, në një vit financiar nuk do të tejkalojnë maksimumin prej 1.5% (një pikë pesë përqind) të vlerës neto të aseteve të Fondit.

4.1.4 Komisionet/tarifat të tjera të mbajtura nga Fondi


- Kosto të transaksioneve për investimin e aseteve të fondit - sipas kushteve të punës të palëve
- ndërmjetësuese.
- Kostot e transaksioneve nuk do të përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por i mbahen Fondit.

Për më shumë informacion për komisionet, ju lutemi shihni faqet përkatëse të prospektit të Fondit, të cilin mund ta gjeni edhe në faqen e internetit www.albsiginvest.al. Portofoli i Fondit të Investimeve Albsig Standard më 31 dhjetor 2025, në përputhje me Politikën e Investimit, përbëhet kryesisht nga obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.



4.1.5. Norma Neto e Kthimit për "Albsig Standard" 2021-2025

Fondi i Investimit Albsig Standard për periudhën 01.01.2025-31.12.2025 ka rezultuar me një normë kthimi prej 4.90%. Tarifa e administrimit zbritet përpara llogaritjes së normës së kthimit. Performanca e mëparshme apo performanca afatshkurtër nuk duhet përdorur si udhëzuese e performancës në të ardhmen..



	31.12.2021	31.12.2022	31.12.2023	31.12.2024	31.12.2025
Norma neto e kthimit për Albsig Standard	4.44	-7.11	8.02	10.16	4.90

5 ECURIA E FONDIT TË PENSIONIT ALBSIG

Fondi i adresohet klientëve konservator me tolerancë të ulët rreziku. Fondi investon vetëm në obligacione afatgjata të Republikës së Shqipërisë. Tradicionalisht obligacionet qeveritare janë aseti me rrezikun më të ulët ndër asetet e tjera në tregun e kapitaleve.

5.1. Politika e Investimit

Fondi do të investojë kryesisht në obligacione afatgjata të Shtetit Shqiptar. Element i rëndësishëm që shoqëron investimin për pension është kohëzgjatja e gjatë.

5.1.1. Elementet kryesorë të politikës së investimit:

Objektivi: Optimizimi i normës së kthimit duke ruajtur principalin;
Toleranca për Rrezik: E ulët;
Horizonti i Investimit: Afatgjatë (10-30 vjet);
Likuiditeti: I ulët.
Strategjia e Investimit: Fondi do të ndjekë një strategji të investimit në asete afatgjata. Fondi gjithashtu ka kërkesa të ulta për likuiditet duke konsideruar kohëzgjatjen e qëndrimit të gjatë në fond dhe prurjet periodike nga pagesat automatike të skemave profesionale dhe individuale.


5.1.2. Profili i riskut dhe përfitimit

Risk i ulët						**Risk i lartë**
Përfitime zakonisht të ulëta					**Përfitime zakonisht të larta**	
1	2	3	4	5	6	7

5.1.3. Komisionet/tarifat e Fondit

Shoqëria Administruese do të aplikojë tarifat e mëposhtme:
Tarifa e administrimit të Fondit do të jetë 2.5% (dy pikë pesë përqind) në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit. Vlera neto e aseteve përbëhet nga vlera e përgjithshme e aseteve e zvogëluar nga zbritja e detyrimeve dhe tarifave deri në datën e vlerësimit;

Në rastin e transferimit të aseteve nga Anëtari në një Fond tjetër të menaxhuar nga një Shoqëri tjetër Administruese, tarifa që do të aplikohet do të jetë 0.5% (zero pikë pesë përqind) e shumës së transferuar. Portofoli i Fondit të Pensioneve Privat Albsig më 31 dhjetor 2025, në përputhje me Politikën e Investimit, përbëhet kryesisht nga bono dhe obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.




Shpërndarja e Instrumenteve sipas llojit më 31.12.2025 Albsig Pension (%NAV)

Obligacione

Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre

5.1.4. Norma Neto e Kthimit për "Albsig Pension" 2021-2025



	31.12.2021	31.12.2022	31.12.2023	31.12.2024	31.12.2025
Norma neto e kthimit për Albsig Pension 2021-2025	2.22	2.75	3.81	4.24	4.12

6 ECURIA E FONDIT TË PENSIONIT SMART PENSION

Fondi i adresohet klientëve konservator me tolerancë të ulët rreziku. Fondi investon vetëm në obligacione afatgjata të Republikës së Shqipërisë. Tradicionalisht obligacionet qeveritare janë aseti me rrezikun më të ulët ndër asetet e tjera në tregun e kapitaleve.

6.1. Politika e Investimit

Fondi do të investojë kryesisht në obligacione afatgjata të Shtetit Shqiptar. Element i rëndësishëm që shoqëron investimin për pension është kohëzgjatja e gjatë.

6.1.1. Elementet kryesorë të politikës së investimit:

Objektivi: Optimizimi i normës së kthimit duke ruajtur principalin;
Toleranca për Rrezik: E ulët;
Horizonti i Investimit: Afatgjatë (10-30 vjet);
Likuiditeti: I ulët.
Strategjia e Investimit: Fondi do të ndjekë një strategji të investimit në asete afatgjata. Fondi gjithashtu ka kërkesa të ulta për likuiditet duke konsideruar kohëzgjatjen e qëndrimit të gjatë në fond dhe prurjet periodike nga pagesat automatike të skemave profesionale dhe individuale.


6.1.2. Profili i riskut dhe përfitimit

Risk i ulët						**Risk i lartë**
Përfitime zakonisht të ulëta					**Përfitime zakonisht të larta**	
1	2	3	4	5	6	7

6.1.3. Komisionet/tarifat e Fondit

SShoqëria Administruese do të aplikojë tarifat e mëposhtme:
Tarifa e administrimit të Fondit do të jetë 1.2% (një pikë pesë përqind) në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit. Vlera neto e aseteve përbëhet nga vlera e përgjithshme e aseteve e zvogëluar nga zbritja e detyrimeve dhe tarifave deri në datën e vlerësimit;

Në rastin e transferimit të aseteve nga Anëtari në një Fond tjetër të menaxhuar nga një Shoqëri tjetër Administruese, tarifa që do të aplikohet do të jetë 0.5% (zero pikë pesë përqind) e shumës së transferuar. Portofoli i Fondit të Pensioneve Privat "Smart Pension" më 31 dhjetor 2025, në përputhje me Politikën e Investimit, përbëhet kryesisht nga bono dhe obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.



Shpërndarja e Instrumenteve sipas llojit më 31.12.2025 (%NAV)


Obligacione

Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre

6.1.4. Norma Neto e Kthimit për "Smart Pension" deri më 31.12.2024

Shoqëria Administruese do të aplikojë tarifat e mëposhtme:
Tarifa e administrimit të Fondit do të jetë 1.2% (një pikë pesë përqind) në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit. Vlera neto e aseteve përbëhet nga vlera e përgjithshme e aseteve e zvogëluar nga zbritja e detyrimeve dhe tarifave deri në datën e vlerësimit;

Në rastin e transferimit të aseteve nga Anëtari në një Fond tjetër të menaxhuar nga një Shoqëri tjetër Administruese, tarifa që do të aplikohet do të jetë 0.5% (zero pikë pesë përqind) e shumës së transferuar. Portofoli i Fondit të Pensioneve Privat "Smart Pension" më 31 dhjetor 2025, në përputhje me Politikën e Investimit, përbëhet kryesisht nga bono dhe obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.



	31.12.2024	31.12.2025
Norma neto e kthimit për Smart Pension 2024-2025	5.05	5.55

7.1. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

RSM ALBANIA
Rr.Skender Luarasi, sheshi Gjenerali
Jozef San Martin, Pallati 3Hyrja 19,
Tiranë, Shqipëri
T:+355 69 706 6110
www.rsm.global/albania

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin e ALBSIG INVEST Sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të ALBSIG INVEST Sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2025, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2025, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP-së) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.
Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e të gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione të përgatitura në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të Shoqërisë për vitin 2025 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Nëse arrijmë në përfundimin se ka një gabim material në të, ne jemi të detyruar t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen.

Elona Bisha

Auditues Ligjor

RSM Albania

Tiranë, 31 mars 2026

AUDIT TAX CONSULTING RSM ALBANIA SH.P.K

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM Albania SH.P.K is part of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

7.2. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

ALBSIG INVEST SHA

Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Pasqyra e Pozicionit Financiar

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Aktivet			
Paraja dhe ekuivalentë të saj	6	6,832,598	2,841,525
Të arkëtueshme nga Fondet	7	2,635,287	1,771,685
Shpenzime të parapaguara	8	1,253,163	673,660
Aktive afatgjata jo materiale	9	734,688	562,846
Investime të mbajtura deri në maturim	10	30,000,000	30,000,000
Totali i aktiveve		**41,455,736**	**35,849,716**
Detyrimet			
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	11	2,668,108	2,337,659
Totali i detyrimeve		**2,668,108**	**2,337,659**
Kapitali			
Kapitali i paguar	12	69,000,000	69,000,000
Humbje të mbartura		(35,487,943)	(35,976,504)
Humbje neto e periudhës		5,275,571	488,561
Totali i kapitalit		**38,787,628**	**33,512,057**
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		**41,455,736**	**35,849,716**

Pasqyrat financiare u aprovuan nga Këshilli i Administrimit i Shoqërisë Administruese "Albsig Invest Sh.a", më 31 mars 2026 dhe u firmosën nga:

Z. Irfan LAMI
Drejtor Finance
Albsig Sh.a

Z. Elton KORBI
Administrator i Përgjithshëm
Albsig Invest Sh.a

Shënimet shpjeguese në faqet 5-23 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

7.3. PASQYRA E FITIM OSE HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE

ALBSIG INVEST SHA
Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Fluksi i parasë nga aktiviteti operacional			
Fitimi/Humbja e periudhës		5,275,571	**488,561**
Rregullime për:			
Shpenzime amortizimi	9	314,948	637,079
Fluksi i parasë nga aktiviteti operacional përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues		**5,590,519**	**1,125,640**
Rregullime për kapitalin qarkullues:			
(Rritje)/pakësim në të arkëtueshme nga fondet	7	(863,602)	2,580,297
(Rritje)/pakësim në shpenzime të parapaguara	8	(579,503)	166,200
Rritje/(pakësim) në të pagueshme dhe detyrime të tjera të tjera të pagueshme		330,449	(1,711,473)
Fluksi i parasë neto nga aktiviteti operacional		**4,477,863**	**2,160,664**
Fluksi i parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara neto	9	(486,790)	(687,050)
Investimet	10	-	-
Fluksi neto i parasë i përdorur nga aktivitetet investuese		**(486,790)**	**(687,050)**
Fluksi neto i parasë i përdorur nga aktivitetet financuese		**-**	**-**
Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentë		3,991,073	**1,473,614**
Paraja dhe ekuivalentë në fillim të vitit		2,841,525	1,367,911
Mjete monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit	**6**	6,832,598	**2,841,525**

Shënimet shpjeguese në faqet 5-23 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

7.4. PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

ALBSIG INVEST SHA

Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Pasqyra e flukseve të parasë për periudhën që mbyllet më 31 dhjetor 2025

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Fluksi i parasë nga aktiviteti operacional			
Fitimi/Humbja e periudhës		5,275,571	**488,561**
Rregullime për:			
Shpenzime amortizimi	9	314,948	637,079
Fluksi i parasë nga aktiviteti operacional përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues		**5,590,519**	**1,125,640**
Rregullime për kapitalin qarkullues:			
(Rritje)/pakësim në të arkëtueshme nga fondet	7	(863,602)	2,580,297
(Rritje)/pakësim në shpenzime të parapaguara	8	(579,503)	166,200
Rritje/(pakësim) në të pagueshme dhe detyrime të tjera të tjera të pagueshme		330,449	(1,711,473)
Fluksi i parasë neto nga aktiviteti operacional		**4,477,863**	**2,160,664**
Fluksi i parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara neto	9	(486,790)	(687,050)
Investimet	10	-	-
Fluksi neto i parasë i përdorur nga aktivitetet investuese		**(486,790)**	**(687,050)**
Fluksi neto i parasë i përdorur nga aktivitetet financuese		-	-
Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentë		3,991,073	**1,473,614**
Paraja dhe ekuivalentë në fillim të vitit		2,841,525	1,367,911
Mjete monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit	**6**	6,832,598	**2,841,525**

Shënimet shpjeguese në faqet 5-23 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

7.5. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

ALBSIG INVEST SHA

Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Humbja e akumuluar	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2023	**69,000,000**	**(35,976,504)**	**33,023,496**
Rritje kapitali	-	-	-
Fitimi i periudhës	-	488,561	**488,561**
Gjendja më 31 dhjetor 2024	**69,000,000**	**(35,487,943)**	**33,512,057**
Rritje kapitali	-	-	-
Fitimi i periudhës	-	5,275,571	**5,275,571**
Gjendja më 31 dhjetor 2025	**69,000,000**	**(30,212,372)**	**38,787,628**

Shënimet shpjeguese në faqet 5-23 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

8.1. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Për Drejtimin e Fondit të Investimit ALBSIG STANDARD dhe Shoqërinë Administruese të Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive Albsig Invest sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Investimit ALBSIG STANDARD ("Fondi"), që përfshijnë pasqyrën e të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2025, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël materiale. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më 31 dhjetor 2025, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Fondi në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilisteve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Fondin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Fondi të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Fondit, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur ne përputhje me Ligjin Nr. 25\2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të Fondit për vitin 2025 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe te vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Elona Bisha

Auditues Ligjor

RSM Albania

Tiranë, 30 prill 2026



8.2. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

ALBSIG INVEST SHA
FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD

Pasqyra e Pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Aktivet			
Paraja dhe ekuivalentet e saj	5	34,020,574	29,538,145
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes	6	261,300,378	235,215,820
Totali i aktiveve		**295,320,952**	**264,753,965**
Detyrimet			
Të pagueshme ndaj Shoqërisë Administruese	7	248,969	223,182
Të pagueshme ndaj Bankës Depozitare	8	42,325	37,941
Detyrime të tjera	9	168,490	168,118
Totali i detyrimeve		**459,784**	**429,241**
Aktivet neto që i atribuohen kuotambajtësve kuotave		**294,861,168**	**264,324,724**
Numri i kuotave të emetuara		243,946	229,400
Aktivet neto ndaj një kuote		**1,209**	**1,152**

Pasqyrat financiare u aprovuan nga Këshilli i Shoqërisë Administruese "Albsig Invest Sh.a", më 30 prill 2026 dhe janë firmosur nga:

Z. Irfan LAMI
Drejtor Finance
Albsig Sh.a

Z. Elton KØRBI
Administrator i Përgjithshëm
Albsig Invest Sh.a

Shënimet shpjeguese në faqet 5-18 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

ALBSIG INVEST SHA
FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD

Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Të ardhura nga shitja e instrumenteve financiare	10	-	14,945
Të ardhura nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv	11	13,757,166	13,270,559
Të ardhura të tjera		3,363	136,550
Totali i te ardhurave		**13,760,529**	**13,422,054**
Shpenzimet			
Humbje nga shitja e instrumenteve financiare	10	191,562	258,262
Tarifa e Shoqërisë së Administrimit	12	2,850,401	2,575,205
Tarifa e Bankës Depozitare	13	509,926	478,396
Shpenzime të tjera	14	298,850	285,402
Totali i shpenzimeve		**3,850,739**	**3,597,265**
Të ardhura neto		**9,909,790**	**9,824,789**
Ndryshimi në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes	6	3,180,745	15,092,397
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave		**13,090,535**	**24,917,186**

Shënimet shpjeguese në faqet 5-18 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

8.4. PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

ALBSIG INVEST SHA
FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD

Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Rrjedha e parasë nga aktiviteti operacional			
Rritja në aktivet neto që i atribuohen kuotambajtësve		13,090,535	24,917,186
Të pagueshme ndaj Shoqërisë Administruese	7	25,787	18,294
Të pagueshme ndaj Bankës Depozitare	8	4,384	3,110
Detyrime të tjera	9	372	(99,575)
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes	6	(26,084,558)	(82,999,545)
Rrjedha e parasë neto nga aktiviteti operacional		**(12,963,480)**	**(58,160,530)**
Rrjedha e parasë nga aktiviteti financiar			
Kontribute nga lëshimi i kuotave		29,123,550	15,996,837
Tërheqje e kuotave		(11,677,641)	(27,101,371)
Rrjedha e parasë neto nga aktiviteti financiar		**17,445,909**	**(11,104,534)**
Rritje në para dhe ekuivalentet e saj		**4,482,429**	**(69,265,064)**
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të periudhës		29,538,145	98,803,209
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të periudhës		**34,020,574**	**29,538,145**

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

Shënimet shpjeguese në faqet 5-18 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

8.5.PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË AKTIVET NETO

ALBSIG INVEST SHA
FONDI I INVESTIMIT ALBSIG STANDARD

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto më 31 dhjetor 2025
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

Shënimet shpjeguese në faqet 5-18 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

	Numri i kuotave	Aktivet	Vlera e aktiveve për kuotë
Gjendja më 31 dhjetor 2023	**239,495**	**250,512,072**	**1,046**
Kontribute në kuota gjatë vitit	14,635	15,996,837	1,093
Tërheqje e kuotave gjatë vitit	(24,730)	(27,101,371)	1,096
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave	-	24,917,186	-
Aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave	**229,400**	**264,324,724**	**1,152**
Gjendja më 31 dhjetor 2024	**229,400**	**264,324,724**	**1,152**
Kontribute në kuota gjatë vitit	24,222	29,123,550	1,202
Tërheqje e kuotave gjatë vitit	(9,676)	(11,677,641)	1,207
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave	-	13,090,535	-
Aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave	**243,946**	**294,861,168**	**1,209**
Gjendja më 31 dhjetor 2025	**243,946**	**294,861,168**	**1,209**

9 ALBSIG PENSION

9.1. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

RSM

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Për Drejtimin e Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur ALBSIG dhe Shoqërinë Administruese të Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive Albsig Invest Sh.a.

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur ALBSIG ("Fondi"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2025, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më 31 dhjetor 2025, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Fondi në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilisteve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur

përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Fondin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.

Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Fondi të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.
Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Fondit, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur ne përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të Fondit për vitin 2025 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe te vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Elona Bisha
Auditues Ligjor
RSM Albania
Tiranë, 30 prill 2026

9.2. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

ALBSIG INVEST SHA
FONDI I PENSIONIT PRIVAT ALBSIG

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Aktivet			
Paraja dhe ekuivalentet e saj	5	59,118,479	11,539,569
Aktive financiare me kosto të amortizuar	6	857,171,063	678,298,841
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	17,906,800	14,787,924
Totali i aktiveve		**934,196,342**	**704,626,334**
Detyrimet			
Të pagueshme ndaj Shoqërisë Administruese	7	2,248,237	1,472,481
Detyrime të tjera	8	550,626	312,646
Totali i detyrimeve		**2,798,863**	**1,785,127**
Aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave		**931,397,479**	**702,841,207**
Numri i kuotave të emetuara		774,327	608,410
Aktivet neto ndaj një kuote		**1,203**	**1,155**

Pasqyrat financiare u aprovuan, më 30 prill 2026 dhe u firmosën nga:

Z. Irfan LAMI
Drejtor Finance
Albsig Sh.a.

Z. Elton KORBI
Administrator i Përgjithshëm
Albsig Invest Sh.a

Shënimet shpjeguese në faqet 5-16 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

9.3. PASQYRA E FITIM OSE HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE

ALBSIG INVEST SHA
FONDI I PENSIONIT PRIVAT ALBSIG

Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2025
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Të ardhura nga interesi i aktiveve financiare me kosto të amortizuar	9	52,784,187	38,199,143
Të ardhura nga interesi i depozitave	9	649,277	402,988
Të ardhura të tjera	9	804	858
Totali i të ardhurave		**53,434,268**	**38,602,989**
Shpenzimet			
Tarifa e Shoqërisë së Administrimit	10	20,490,970	14,712,913
Shpenzime të tjera		859	611
Totali i shpenzimeve		**20,491,829**	**14,713,524**
Të ardhura neto		**32,942,439**	**23,889,465**
Amortizimi i primit të aktiveve me kosto	6	132,618	480,381
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave		**33,075,057**	**24,369,846**

Shënimet shpjeguese në faqet 5-16 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

9.4. PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

ALBSIG INVEST SHA
FONDI I PENSIONIT PRIVAT ALBSIG

Pasqyra e flukseve të parasë për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2025
(Shumat ne Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Rrjedha e parasë nga aktiviteti operacional			
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave		33,075,057	24,369,846
Të pagueshme ndaj Shoqërisë Administruese	7	775,756	434,537
Të arkëtueshme të tjera	6	(3,118,876)	(4,807,999)
Aktive financiare me kosto të amortizuar	6	(178,872,222)	(196,885,530)
Detyrime të tjera	8	237,980	(60,543)
Rrjedha e parasë neto nga aktiviteti operacional		**(147,902,305)**	**(176,949,689)**
Rrjedha e parasë nga aktiviteti financiar			
Kontribute nga lëshimi i kuotave		244,509,083	215,522,400
Tërheqje e kuotave		(49,027,868)	(30,776,492)
Rrjedha e parasë neto nga aktiviteti financiar		**(195,481,215)**	**184,745,908**
Rritje në para dhe ekuivalentet e saj	5	47,578,910	7,796,219
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të periudhës		11,539,569	3,743,350
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të periudhës		**59,118,479**	**11,539,569**

Shënimet shpjeguese në faqet 5-16 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

9.5. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË AKTIVET NETO

ALBSIG INVEST SHA
FONDI I PENSIONIT PRIVAT ALBSIG

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto më 31 dhjetor 2025

	Numri i kuotave	Aktivet	Vlera e aktiveve për kuotë
Gjendja më 31 dhjetor 2023	**445,507**	**493,725,453**	**1,108**
Kontribute në kuota gjatë vitit	190,068	215,522,400	1,134
Tërheqje te parakohshme nga fondi	**(27,165)**	**(30,776,492)**	**1,133**
Fitimi neto nga investimet		24,369,846	
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave		209,115,754	
Aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave	**608,410**	**702,841,207**	**1,155**
Gjendja më 31 dhjetor 2024	**608,410**	**702,841,207**	**1,155**
Kontribute në kuota gjatë vitit	207,550	244,509,083	1,178
Tërheqje nga fondi	(41,633)	(49,027,868)	1,178
Fitimi neto nga investimet		33,075,057	
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të		228,556,272	
Aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave	**774,327**	**931,397,479**	**1,203**
Gjendja më 31 dhjetor 2025	**774,327**	**931,397,479**	**1,203**

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

Shënimet shpjeguese në faqet 5-16 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

10.1. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

RSM

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Për Drejtimin e Fondit të Pensionit Privat "Smart Pension" ALBSIG INVEST Sh.a dhe Shoqërinë Administruese të Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive Albsig Invest Sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Pensionit Privat "Smart Pension" ALBSIG INVEST Sh.a ("Fondi"), që përfshijnë pasqyrën e të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2025, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më 31 dhjetor 2025, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Fondi në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilisteve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Fondin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.

Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse

këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë.
Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Fondi të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Fondit, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur ne përputhje me Ligjin Nr. 25\2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të Fondit për vitin 2025 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Elona Bisha
Auditues Ligjor
RSM Albania
Tiranë, 30 prill 2026

10.2. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

ALBSIG INVEST SHA
FONDI I PENSIONIT PRIVAT SMART PENSION

Pasqyra e Pozicionit Financiar
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Aktivet			
Paraja dhe ekuivalentet e saj	5	17,313,914	6,651,384
Aktive financiare me kosto të amortizuar	6	119,713,989	55,857,571
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	2,446,054	1,449,129
Totali i aktiveve		**139,473,957**	**63,958,084**
Detyrimet			
Të pagueshme ndaj Shoqërisë Administruese	7	138,081	76,021
Detyrime të tjera		26,452	3,300
Totali i detyrimeve		**164,533**	**79,321**
Aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të		**139,309,424**	**63,878,763**
Numri i kuotave të emetuara		120,252	57,926
Aktivet neto ndaj një kuote		**1,158**	**1,103**

ALBSIG INVEST SHA
FONDI I PENSIONIT PRIVAT SMART PENSION

Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Të ardhura nga interesi i aktiveve financiare me kosto të amortizuar	8	6,336,750	2,602,010
Të ardhura nga interesi i depozitave	8	174,315	49,550
Të ardhura nga shitja & maturimi i instrumenteve financiare dhe të ardhura të tjera	8	138	102
Totali i të ardhurave		**6,511,203**	**2,651,662**
Shpenzimet			
Tarifa e Shoqërisë së Administrimit	9	1,408,780	573,265
Shpenzime të tjera		72,159	88
Totali i shpenzimeve		**1,480,939**	**573,353**
Të ardhura neto		**5,030,264**	**2,078,309**
Amortizimi i primit të aktiveve me kosto të amortizuar	6, 8	(91,557)	(18,959)
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave		**4,938,707**	**2,059,350**

Shënimet shpjeguese në faqet 5-17 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

10.4. PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

ALBSIG INVEST SHA
FONDI I PENSIONIT PRIVAT SMART PENSION

Pasqyra rrjedhjes se parasë
(Shumat ne Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Rrjedha e parasë nga aktiviteti operacional			
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave		4,938,707	2,059,350
Të pagueshme ndaj Shoqërisë Administruese	7	62,060	54,656
Të arkëtueshme të tjera	6	(996,925)	(955,098)
Aktive financiare me kosto të amortizuar	6	(63,856,418)	(38,703,830)
Detyrime të tjera		23,152	3,300
Rrjedha e parasë neto nga aktiviteti operacional		**(59,829,424)**	**(37,541,622)**
Rrjedha e parasë nga aktiviteti financiar			
Kontribute nga lëshimi i kuotave		72,056,958	44,156,245
Tërheqje e kuotave		(1,565,004)	(151,414)
Rrjedha e parasë neto nga aktiviteti financiar		**70,491,954**	**44,004,831**
Rritje në para dhe ekuivalentet e saj		10,662,530	6,463,209
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të periudhës		6,651,384	188,175
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit	**5**	**17,313,914**	**6,651,384**

Shënimet shpjeguese në faqet 5-17 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

10.5. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË AKTIVET NETO

ALBSIG INVEST SHA
FONDI I PENSIONIT PRIVAT SMART PENSION

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto

	Numri i kuotave	Aktivet	Vlera e aktiveve për kuote
Gjendja më 31 dhjetor 2023	**17,052**	**17,814,582**	**1,045**
Kontribute në kuota gjatë vitit	41,015	44,156,245	1,077
Tërheqje nga fondi	(141)	(151,414)	1,074
Fitimi neto nga investimet		2,059,350	
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave	40,874	46,064,181	1,127
Gjendja më 31 dhjetor 2024	**57,926**	**63,878,763**	**1,103**
Kontribute në kuota gjatë vitit	63,716	72,056,958	1,131
Tërheqje nga fondi	(1,390)	(1,565,004)	1,126
Fitimi neto nga investimet		4,938,707	
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave	62,326	75,430,661	1,210
Aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave	**120,252**	**139,309,424**	**1,158**
Gjendja më 31 dhjetor 2025	**120,252**	**139,309,424**	**1,158**

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

Shënimet shpjeguese në faqet 5-17 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

ALBSIG

PJESË E KASTRATI GROUP

info@albsig.al
www.albsig.al

+355 (0) 44502060 / +355 (0) 42254770

ALBSIG sh.a.
Bulevardi Bajram Curri, Albsig HQ, Kati 16&17,
1010 - Tirana, Albania